



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.11.2018, ora 12:00

Kryetare e Komisionit – Mimi Kodheli

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 22 tetor 2018
2. Miratimi i kalendarit për projektligjin “Buxheti i shtetit 2019”
3. Shqyrtimi në parim dhe paraqitja nga ministri i Shtetit për Diasporën i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”
4. Projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, që ndryshon Memorandumin e Mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit European”
5. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)
6. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”
7. Çështje të tjera

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Andrea Marto, Adnor Shameti, Klotilda Bushka, Eglantina Gjermeni, Xhemal Qefalia, Ilir Xhakolli, Vasilika Hysi, Evis Kushi, Ervin Bushati, Bashkim Fino

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjoshaj, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Rudina Hajdari, Edmond Panariti dhe Elona Gjebrea.

Të ftuar:

Pandeli Majko- Ministër i Shtetit për Diasporën

Dritan Delija- Drejtor i Agjencisë Kombëtare për Diasporën

Soana Jaupllari- Drejtore e Fondit Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës

Gentian Opre- Drejtor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Ina Dhaskali- Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Rovena Voda- Zëvendësministre e Brendshme

Alma Mehmeti- shefe e Sektorit Juridik në Ministrinë e Brendshme

Silvana Dervishi- specialiste në Ministrinë e Brendshme

Ilir Bejkos- Drejtor i Vlerësimit të Legjislacionit, në Ministrinë e Drejtësisë

Shpresa Shahaj- Përgjegjëse e Sektorit në Drejtorinë e Traktateve dhe Marrëveshjeve në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Migena Baholli- specialiste në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Ilir Halilaj- Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Pjerin Shoshi- Drejtor i Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural

Edlira Llango- Drejtore Juridike

Elma Vathi- shefe e Sektorit të Koordinimit dhe Integrimit

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita!

Fillojmë sot mbledhjen e Komisionit të Politikës së Jashtme.

Në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbalit të datës 22 tetor; miratimin e kalendarit për projektbuxhetin e vitit 2019; shqyrtimin në parim dhe paraqitjen nga ana e ministrit të Shtetit për Diasporën të projektligjit për buxhetin e vitit 2019; miratimin e projektligjit “Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë së Bashkimit Europian; projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në mes Këshillit të Ministrave dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, si edhe projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2017 për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes Fondit të Garancisë së Kredive Rurale”.

Ju lutem, kolegë, do të miratojmë procesverbalin e datës 22 tetor, si edhe kalendarin për projektligjin e buxhetit të vitit 2019. Kush është dakord me kalendarin?

Miratohet.

Kalojmë te shqyrtimi në parim i projektbuxhetit të vitit 2019.

Të pranishëm kemi ministrin e Shtetit për Diasporën, zotin Majko, si edhe stafin e tij ndihmës.

Mirë se erdhët!

Para se t’ia jap fjalën relatores, së pari, dua t’ju falënderoj, kolegë, për durimin që patët në pritje të ardhjes së kolegëve të tjerë nga Komisioni i Ekonomisë.

Mendoj se diskutimi i projektbuxhetit të vitit 2019 është një garanci e mbështetjes financiare që qeveria jep për fillimin e reformave në sektorë të rëndësishëm strategjikë të vendit.

Sigurisht, ka edhe shumë risi, të cilat vijnë me një konfigurim të ri që qeveria pati një vit më parë, duke krijuar Ministrinë e Diasporës, e cila sot vjen me paraqitjen dhe mbrojtjen e projektbuxhetit për vitin 2019, ndaj e vlerësoj këtë mbledhje si ndër më të rëndësishmet.

Fjalën e ka zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit!

Së pari, ju kërkoj ndjesë për vonesën, sepse ishim në mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë në diskutimin e projektligjit “Për projektbuxhetin e vitit 2019”.

Në diskutimin e këtij projektligji në këtë komision do të fokusohem në tri pika kryesore: zhvillimet ekonomike të vitit 2018; karakteristikat kryesore të projektbuxhetit të vitit 2019 dhe rekomandimet ose sugjerimet që ne mendojmë se duhen mbajtur në konsideratë për mbarëvajtjen sa më mirë të buxhetit dhe realizimin sa më mirë të tij.

Projektbuxheti në themel ka objektivat e kuadrit makroekonomik dhe fiskal afatmesëm për tre vjetët në vijim, ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit, krijimin e klimës, për një rritje të qëndrueshme ekonomike si edhe konvertimin sa më shpejt drejt nivelit të mirëqeverisjes së Bashkimit Europian.

Projektligji përcakton drejtimet kryesore për realizimin e këtyre objektivave, të cilat janë: targetimi i një trajektore rënëse të borxhit publik, mbajtja e një nivel investimesh publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal dhe mundësisht afër nivelit optimal të tij prej 5% të produktit të brendshëm bruto, harmonizimi me objektivin themelor të politikës monetare për stabilitetin e çmimeve, si dhe zbutja e deficitit të llogarisë korente dhe përmirësimin e pozicionit të jashtëm të ekonomisë, duke tentuar gjithmonë rritjen graduale të rezervave valutore.

Projektbuxheti mban në konsideratë vlerësimet dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare. Këtu kam parasysh komisionin Europian, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore, si edhe të gjitha agjencitë e tjera ndërkombëtare, që mbikëqyrin ekonominë e vendit tonë. Politikat dhe treguesit e tij, si çdo vit, janë konsultuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Institucionet financiare ndërkombëtare kanë vlerësuar se ekonomia shqiptare po zhvillohet pozitivisht dhe me ritme të qëndrueshme, duke arritur një normë më të lartë rritjeje se mesatarja e Ballkanit Perëndimor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam dakord. Mendova se mos duhej një panoramë e përgjithshme.

Në projektbuxhetin e vitit 2019 është parashikuar shërbimi për diasporën sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore me këto shpenzime: totali i shpenzimeve korente 47 milionë lekë, financimi i brendshëm 36 milionë lekë, totali i shpenzimeve kapitale 36 milionë lekë dhe totali i shpenzimeve buxhetore 83 milionë lekë.

Në zbatim të ligjit nr. 16 të vitit 2018 “Për diasporën” qeveria ka ngritur një sërë aktesh për zbatimin e parashikimeve në ligj. Ndër to është vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 469, datë

26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimit për Diasporën”, e cila në projektbuxhetin e vitit 2019 është planifikuar që të ketë 13 punonjës. Gjithashtu, një zë i parashikuar në buxhet është edhe Agjencia për Diasporën, e cila është ngritur në vitin 2018 dhe është parashikuar që edhe për vitin 2019 të ketë 15 punonjës me buxhet në shumën 17 milionë lekë.

Këto janë parashikimet e buxhetit posaçërisht për Ministrinë e Diasporës. Për detaje të tjera ia lë fjalën ministrit dhe stafit.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Kushi!

Gjatë kohës që ishim në pritje të kolegëve, u përditësuam me paraqitjen jo vetëm elektronike, por edhe të printuar që ministri i Shtetit për Diasporën, zoti Majko, na vuri bëri. Kështu të gjithë u njohëm me çka ministri ka paraqitur për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve të agjencive kombëtare, por edhe të Fondit Shqiptar për Mbulimin e Diasporës dhe të vetë institucionit që drejton.

Meqenëse jemi në limitet e kohës, mendoj, zoti Ministër, të mos bëjmë paraqitjen, siç e kishim menduar, të të gjithë asaj që keni sjellë në *power point*, por shkurtimisht të flisni për kërkesat dhe aktivitetin e vitit në vazhdim.

Fjala për ju, zoti Ministër.

Pandeli Majko- Faleminderit!

Unë sot vij për të paraqitur buxhetin e disa prej agjencive kryesore që, në bazë të legjislacionit të miratuar nga ky parlament, gjatë vitit në vazhdim janë krijuar me vendim të posaçëm, më pas me akte ligjore nga ana e qeverisë, si Agjencia e Diasporës, Fondi i Zhvillimit për Diasporën dhe Qendra e Botimeve për Diasporën.

Dëshiroj të bëj një shpjegim për buxhetin për diasporën. Nuk ka buxhet për diasporën. Unë jam ministër shteti dhe nuk kam buxhet si ministër. Bëhet fjalë për tri agjenci kryesore: Agjencia për Diasporën, e cila ka filluar funksionimin e vet këtë vit dhe Qendrën për Fondin e Zhvillimit për Diasporën, e cila sapo ka filluar funksionimin.

Dua të nënvizoj faktin që këto institucione të krijuara me legjislacionin, që është miratuar në Kuvend, drejtohen nga këshilla drejtues, të cilët kanë brenda vetes në nivel zëvendësministri përfaqësues nga institucione të ndryshme. Në të gjitha këto institucione zëvendësministri i Financave është i kudondodhur, si titull. Të gjitha këto institucione kanë sjellë qoftë pranë,

qeverisë qoftë në parlament kanë sjellë propozimet e tyre dhe unë kam marrë përsipër t'i përfaqësoj në këtë komision të nderuar.

Dëshiroj të them se ne e kemi filluar diskutimin dhe politikën shtetërore për diasporën me një shumë modeste prej 22 milionë lekësh të rinj pa u miratuar ligji për Agjencinë Kombëtare të Diasporës. Duke pasur mirëkuptimin edhe të parlamentit, edhe të opozitës sidomos, ky fond u miratua në Kuvend dhe pastaj u kalua legjislacioni duke mos krijuar vakuum administrativ.

Sot që flasim ne kemi një agjenci diaspore, e cila ka filluar funksionimin e saj, por dëshiroj të them se, pavarësisht përkrahjes që keni pasur nga Ministria e Financave kërkesat e Agjencisë mbeten ende të larta krahasuar me ato që ka dhënë si buxhet Ministria e Financave. Të jem i sigurtë unë sot nuk do të kisha ardhur të thosha asnjë fjalë, nëse këtë çështje nuk do ta kisha ngritur në qeveri dhe komitetin strategjik të diskutimeve, ku është diskutuar buxheti.

Ne ndodhemi para një situatë të tillë dhe dua të tërheq këtu vëmendjen edhe të kolegëve të Komisionit të Jashtëm dhe të Komisionit të Ekonomisë, sepse qeveria ka kaluar strategjinë kombëtare të diasporës së bashku me planin e veprimit. Aty parashikohen edhe shifrat për t'u shpenzuar për agjencinë dhe politikën shtetërore për diasporën. Unë mendoj se ne duhet të respektojmë këto shifra, që janë miratuar edhe me dakordësinë e Ministrisë së Financave, kur ka kaluar vendimi i qeverisë, edhe si propozim kur në prani të zëvendësministrit të Financave qoftë në këshillin drejtues të Agjencisë së Diasporës, qoftë në atë të Fondit të Zhvillimit janë kaluar këto shifra.

Nuk e citova pa një tendencë faktin që në të gjithë këshillat drejtues të këtyre agjencive, që do të formulojnë politikën shtetërore të diasporës, do të jenë përfaqësuesit e Ministrisë së Financave. Do të thotë që të gjitha shpenzimet, kuotimet të gjitha mënyrat e trajtimit të buxhetit do të jenë nën vëzhgimin e pandërprerë të Ministrisë së Financave në një nivel më të lartë që është zëvendësministri, që do të thotë që edhe këto shifra janë të miratuara nga ana e këtyre këshillave drejtuese.

Sigurisht në të gjitha *slidet* keni shifra, të cilat janë të propozuara edhe nga këto këshilla, por dëshiroj të them se shifra 26,5 milionë, që propozohet për vitin që vjen për Agjencinë e Diasporës, është shumë e vogël. Kini parasysh se vitin që vjen do të bëhet samiti i dytë i diasporës, i cili kërkon angazhime të veçanta.

Për sa i përket trajtimit të investimit në këtë drejtim, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, është rënë dakord që zëri i veçantë do të vendoset ose te Këshilli i Ministrave, ose te Drejtoria e Zhvillimit Qeveritar. Jemi duke negociuar për këtë.

Sa i përket ngritjes së qendrave kulturore, për të cilat mendoj se ka një keqkuptim me Ministrinë e Financave, që e ka trajtuar si buxhet të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, ky nuk është zë i Agjencisë Kombëtare të Diasporës, por zë i Ministrisë së Jashtme. Ne kemi komunikuar me përfaqësuesit dhe kolegët tanë në qeverinë e Kosovës, pasi në bazë të marrëveshjeve ndërshtetërore që kemi me qeverinë e Kosovës, do të ndahen shpenzimet gjysmë për gjysmë për blerjen qendrave të kulturës për diasporën. Kjo do të thotë që të njëjtin buxhet që e kanë vendosur ata, do ta vendosim edhe ne. Sigurisht, kjo do të jetë një temë e diskutimit në mbledhjen e përbashkët që do të zhvillohet së shpejti në Pejë midis dy qeverive tona, por dëshiroj të them faktin që ne i kemi çuar Ministrisë së Financave shifrën që ka miratuar qeveria e Kosovës.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave për fillimin e punës së Fondit të Zhvillimit të Diasporës kemi kaluar një program 3-vjeçar pasi Fondi i Zhvillimit të Diasporës nuk është institucion buxhetor, por është institucioni publik, i cili do të funksionojë i bazuar në programe. Një nga programet e para që do të inicojë strukturimin e hapave të parë administrative të krijimit të fondit të zhvillimit të diasporës është pikërisht programi i miratuar nga qeveria me 100 milionë lekë të rinj për 3 vjet. Deri në vitin 2021 do të jetë një program, i cili do të ketë të bëjë me një varg detajesh që janë të lidhura me qëllimet e strategjisë kombëtare të diasporës. Ky është një lajm shumë i mirë.

Sa i përket fondit që i dedikohet fondit të zhvillimit të diasporës, unë nuk kam asnjë vërejtje me përjashtim të faktit që mbase është një lapsus që në buxhetin që ka ardhur për fondin e zhvillimit të diasporës buxheti është 30 milionë lekë, kur, në fakt, në bazë të vendimit të qeverisë, bërë në negociatë shumë të ngushtë me ministrin e Financave, duhet të jetë 44 milionë, është shifër e fiksuar në vendimin e qeverisë për programin në fjalë dhe gjithçka ne e kemi bërë në bashkëpunim me këtë ministri.

Sa i përket Qendrës së Botimeve të Diasporës, këtu do të ndalem pak. Ajo do të zëvendësojë qendrën BOTEM. Me këtë emër dhe ky zëvendësim do të fillojë nga data 1 janar, që do të thotë sa do të jetë buxheti i Qendrës së Botimeve për Diasporën do të vendoset me zërin e qendrës BOTEM, e cila aktualisht është nën Ministrinë e Arsimit. Desha të shpreh një rezervë të vogël në lidhje me këtë çështje, sa i përket qendrës BOTEM, e cila nga 1 janari do të bëhet Qendra

e Botimeve për Diasporën. Është vendosur shifra 26,5 milionë lekë të rinj, që nuk ka ndonjë diferencë të madhe me atë që ka pasur qendra BOTEM, e cila nxjerr botime për minoritetet.

Tani unë desha të bëj një pyetje, nuk është retorike, as me sens ironie karshi atyre që kanë bërë buxhetin në Ministrinë e Financave. Numri i minoritarëve në Shqipëri dihet, por ai nuk mund të jetë i krahasueshëm në asnjë rast edhe nga pikëpamja buxhetore me numrin e fëmijëve që studiojnë jashtë kurrikulën për gjuhën shqipe. Numri i fëmijëve që studiojnë aktualisht në shkolla është i madh. Ka kërkesa që vijnë nga shtete të ndryshme sa i përket furnizimit me abetare ose libra të ndryshëm. Duke filluar nga 1 janari ky furnizim do të bëhet nga Qendra e Botimeve për Diasporën. Deri tani ka funksionuar sistemi që ambasadat çonin kërkesat te Ministria e Jashtme, e cila i çonte te Ministria e Arsimit, i cila ofronte librat sipas kërkesave. Tani këtë do ta marrë përsipër Qendra e Botimeve për Diasporën, sigurisht duke bashkëpunuar me Ministrinë e Jashtme.

Ne po punojmë për kurrikulën e re, për të cilën ka marrëveshje midis Ministrisë së Arsimit tonë dhe asaj të Kosovës. Po punojmë edhe për projektin e librit dixhital sa i përket kësaj çështjeje. Kemi në diskutim edhe dhënien e mësimit në televizionin, që i kushtohet diasporës, TV3. Por të gjitha këto kërkojnë shpenzime dhe të gjitha këto nuk mund të trajtohen si një moment, i cili kalon nga BOTEM te qendra, por është një ndryshim shumë i madh cilësor dhe sasior. Prandaj kolegët të më mirëkuptojnë, siç më ka kuptuar ministri i Financave kur kemi zhvilluar diskutime të kësaj natyre.

Është hera e parë që në mënyrë kaq të strukturuar ne diskutojmë interesat e diasporës, pra nuk diskutojmë në hava, me nene që kërkonin gjithçka dhe nuk detajonin asgjë, po flasim për njësi autonome, siç është Agjencia Kombëtare e Diasporës, është Qendra e Botimeve për Diasporën dhe Fondi i Zhvillimit për Diasporën. Po flasim për një samit, i cili do të zhvillohet vitin që vjen, ku do të diskutohen të gjitha dokumentet kryesore, pasi ne jemi të hapur për ndryshimet e natyrave të ndryshme. Duke u nisur nga të gjitha eksperiencat që ekzistojnë, është pak e vështirë që unë t'i kërkoj Ministrisë së Financave që me një trokitje të zgjidhë gjithçka. Ka një traditë të munguar në administratën shqiptare për mënyrën e të shërbyerit të qytetarëve jashtë vendit. Për këtë arsye ne po përpiqemi të gjejmë modelet më të mira, duke bashkëpunuar edhe me Organizatën e Kombeve të Bashkuara me Zyrën e IOM-it në Tiranë, dhe kemi filluar me ta një projekt, që është edhe palë e një donacioni të qeverisë italiane, dhe thjesht jemi në hapat e parë. Nuk bëhet fjalë për një investim të jashtëzakonshëm, këtë e them duke u bazuar në një eksperiencë modeste, sepse nuk besoj se e tejkalon çerekun e vlerës së mbetjeve të tenderëve që zhvillohen në

shtetin shqiptar. Nuk besoj se ne do të jemi dorështrenguar pikërisht për këtë çështje, sidomos e kam fjalën për Qendrën e Botimeve për Diasporën dhe për Agjencinë Kombëtare të Diasporës. Këto janë institucione, të cilat ose i kemi dhe funksionojnë, ose nuk i kemi. Bazuar mbi këtë logjikë, besoj se kolegët e mi do t'i kem në krahë për të bërë një rritje sado të rëndësishme dhe të vlefshme, e cila ka të bëjë me një moment shumë substancial, sepse duket sikur ministri i Shtetit për Diasporën ka ardhur këtu për t'u ankuar. Unë e përsëris: nuk do të kisha thënë asnjë fjalë nëse nuk do të kisha folur me këtë gjuhë në qeveri apo në komitetin ku u diskutua çështja e buxhetit.

Sigurisht, ne kemi një administratë, e cila ende nuk e ka të qartë, nga pikëpamja financiare, se si do t'i mbulojë shpenzimet, sepse ende nuk kemi krijuar modelet tona. Ky është viti ynë i parë, është buxheti ynë i parë për të cilin ne do të aplikojmë financat e shtetit shqiptar për një politikë shtetërore për diasporën. Kështu që diskutime të natyrave të tilla besoj se janë të kuptueshme, janë të dobishme dhe në asnjë rast nuk dua të krijoj ndarje me kolegun tim Ahmetaj, me ministrin e Financave. Mendoj se ne jemi pjesë e një debati në vazhdim se si do t'i aplikojmë këto buxhete që kemi me shtetin shqiptar për këto politika shtetërore. E theksoj përsëri, ky është buxheti ynë i parë për diasporën.

E nderuar kryetare dhe të nderuar kolegë, duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, jam i gatshëm t'u përgjigjem pyetjeve tuaja në çdo moment.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Ministër!

A ka pyetje? Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Ju dëgjova me shumë vëmendje dhe nëse është e mundur do të doja të dija një shifër të saktë: sa fëmijë shqiptarë studiojnë jashtë vendit? Faleminderit!

Pandeli Majko – Unë nuk besoj se kam një numër të saktë, por dua t'ju them vetëm një gjë: gati gjysma e popullsisë ndodhet në diasporë. Nuk kemi bërë ndonjë përllogaritje në këtë drejtim, pavarësisht se INSTAT-i mund të ketë ndonjë rezervë për sa i përket kësaj që po them unë, sepse një pjesë e njerëzve që janë larguar nga Shqipëria tani kanë bërë edhe letra, siç thuhet në gjuhën e emigrantëve tanë, në shtetet ku jetojnë dhe kanë ndryshuar edhe vendbanimin. Ajo që dua të them është se ne kemi një problem shumë të madh me shpërndarjen e librit për një arsye shumë të thjeshtë. Nga të gjitha testimet që janë bërë vetëm 10% e fëmijëve studiojnë në kurset e krijuara të gjuhës shqipe. Kështu që një nga gjërat me të cilat do të merret Qendra e Botimeve për

Diasporën do të jetë krijimi i librit online apo i librit dixhital, pasi është shumë e vështirë që t'i dërgojmë librat jashtë vendit.

Sot ne kemi shtetas shqiptarë që jetojnë në Alaskë deri në Australi dhe është shumë e vështirë që t'u krijosh kurse dhe kushte të gjithë këtyre shtetasve, në një kohë që ne po krijojmë të gjitha mundësitë. Ne po diskutojmë me Ministrinë e Financave dhe me RTSH-në që të bëjmë të mundur mësimin e gjuhën shqipe nëpërmjet televizionit dhe të fillojë botimi i të gjitha librave në formë dixhitale, me qëllim që një shtetas, që jeton në Australi apo në Kanada të mos presë kargon e librave nga Shqipëria, por ta marrë online.

Mimi Kodheli – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Mua më vjen mirë që sinjeriteti i ministrit Majko është i tillë, që atë që ka thënë në qeveri dhe në komitet e thotë edhe këtu. Kjo është shumë gjë e mirë, sepse zakonisht kur miratohet një projektbuxhet në përgjithësi ne i ikim idesë se ky projektbuxhet është politik dhe duhet miratuar. Të mos harrojmë se ky është një institucion i ri dhe ky është buxheti i parë që bëjmë për këtë institucion dhe mbase specialistët e Ministrisë së Financës janë të paorientuar. Pra, ne kemi një institucion të ri dhe shumë mirë që është ngritur. Më parë ne nuk financonim asgjë për këtë institucion, pra jepnim zero lekë për diasporën, kurse sot kemi një buxhet të mirëfilltë, që do ta kalojmë, pavarësisht se ministri kërkon më tej. Pyetja ime është: a duhet të shikojmë mundësinë e financimeve të huaja, pse jo edhe të diasporës në tërësi? Cili është qëllimi i saj, përveç buxhetit të shtetit që bëjmë ne? Janë disa elemente, për të cilat ne duhet të kërkojmë mundësi financimi të huaja ose nga diaspora, sepse është një gjë shumë interesante. Nëse do të ishin këtu edhe përfaqësuesit të Ministrisë së Financave do të na jepnin ndonjë ide.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Natyrisht, në formë grantesh, sepse nuk po them që t'i fusim në buxhet, por të pasqyrohen në planifikimin buxhetor. Kjo është shumë e rëndësishme dhe duhet bërë, sepse zoti Majko tha se nga 30 milionë i duhen 44 milionë. Nëse bëhet fjalë për vetëm kaq pak, mendoj se kjo është një gjë simbolike dhe nuk ia vlen të diskutojmë kaq gjatë. Ndaj, duhet t'i themi komisionit përgjegjës që duam ta bëjmë këtë gjë, sepse e kemi për herë të parë dhe kërkojmë jo 30 milionë, por 44 milionë, dhe të shikojmë mundësinë për ta rregulluar këtë gjë.

Problemi është që të rregullohet përfundimisht buxheti i diasporës, që më pas nga viti në vit të mos kemi më probleme me buxhetin dhe ata 10 apo 15 vetë që do të punojnë, të marrin fondin e pagës, sigurimet e të tjerë, por të diskutojmë probleme të tjera se çfarë do të bëjmë me

financimet e huaja. Pra, ne duhet të kemi një strategji të plotë në përmbushjen e projektbuxhetit. Prandaj, unë jam i mendimit, nuk e di çfarë mendimi ka Ministria e Financave, që t’ia bëjmë propozimin komisionit përkatës për një gjë të tillë, por jam edhe i mendimit që të shikojmë mundësinë e financimeve të huaja, sepse janë shumë të rëndësishme. Në rastin konkret është një institucion i ri dhe, po të ketë edhe financime të huaja, do të jetë një gjë shumë e mirë. Faleminderit!

Mimi Kodheli – Po, zoti Shameti, fjala për ju.

Andor Shameti – Faleminderit, zonja Kryetare!

Në mbështetje të të gjithë referimit që parashtroi zoti Fino, si ekspert i ekonomisë, por edhe në cilësinë e kryetarit të Nënkomisionit për Diasporën dhe Emigracionin, dua t’i bëj me dije Komisionit për Politikën e Jashtme disa mendime të miat për këtë projektbuxhet.

Në radhë të parë përshëndes vizionin e qeverisë për krijimin e strukturës së ministrit të Shtetit për Diasporën, vitin e kaluar në strukturën e qeverisë, dhe vizionin e zotit Majko si ministër i Shtetit për Çështjet e Diasporës dhe Emigracionin. Marr shkas nga një vizitë e fundit që kemi bërë në Republikën e Irlandës për çështjet e emigracionit dhe diasporës dhe më vjen shumë mirë që qasja e të gjithë programit politik të qeverisë dhe aq më tepër e ministrit të Shtetit për Diasporën konvergojnë në mënyrë perfekte me atë që cilësohet edhe si modeli më i mirë në botë, ai i Republikës së Irlandës për afrimin dhe ngritjen e marrëdhënieve me të ikurit e diasporës në një nivel të atillë që të jetë shembull dhe model orientimi dhe frymëzimi për Shqipërinë, por edhe për vende të tjera rreth e rrotull, që kanë probleme të emigracionit apo të diasporës në veçanti.

Duke e mbyllur, dua të ngre një çështje të rëndësishme që më ka impresionuar dhe që duhet ta përmend. Rëndom nga përfaqësues të opozitës kam dëgjuar që duan ta etiketojnë ikjen apo lëvizjen e njerëzve jashtë shtetit si një *brain drain*, apo ikje e trurit. Qasja e asaj që kemi parë në Irlandë, nuk shihet si një ikje, por si një fitore e trurit, sepse me teknologjinë dhe me mënyrat e komunikimit që janë sot, është lehtësisht e realizueshme që çdo shqiptar të japë kontributin e tij në Republikën e Shqipërisë edhe pa qenë fizikisht. Irlanda, e cila ka 4 milionë banorë në territorin e saj, ka rreth 80 milionë banorë nëpër botë, që janë me origjinë irlandeze. Ajo që është e rëndësishme është që ta ngresh kombin në eter, pa e lidhur detyrimisht me një territor të caktuar. Uroj që të gjitha pritshmëritë dhe gjetjet e ministrit të Shtetit për Diasporën dhe i gjithë programi politik i qeverisë të realizohen ashtu siç janë parashikuar.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Shameti! Dua të bëj një koment për atë që ju po flisni, irlandezët kanë pasur një favor të rëndësishëm ku kanë shkuar, sepse kanë shkuar në vende ku

flitej e njëjta gjuhë nga vendi ku janë larguar, pavarësisht dialektit. Pra ata nuk kanë pasur probleme të ekzistencës dhe mbijetesës së tyre për shkak të gjuhës. Mund të kenë pasur probleme për shkak të një identiteti tjetër, që mund të jetë ai fetar apo krahinor, ndërsa për ne gjuha është shumë më e rëndësishme, mbi të gjitha është ajo që ne na bashkon si komb.

Unë jam dakord me atë çfarë tha kolegu Fino, por duhet të kërkojmë nga vendet fqinje, aty ku numri i të larguarve nga Shqipëria është më i madh dhe janë rezident atje, se sa është numri i banorëve me origjinë shqiptare me dokumente, pa dokumente, me nënshtetësi tjetër, me pasaportë tjetër, me leje qëndrimi e kështu me radhë. Gjë të cilën nuk e kemi sot, prandaj nuk mund të shkojmë me një shumë konkrete ku mund të ndajmë shpenzimet mes buxhetit që po flasim dhe atij që na ofrohet.

Kam një pyetje, nuk e di mbase nuk të kam kuptuar deri në fund, zoti Ministër, por kam idenë që edhe këtë vit jeni në dilemë nëse do t'i botoni abetaret në gjuhën shqipe apo do të shfrytëzoni internetin që këto abetare t'i transportoni elektronikisht, duke marrë parasysh edhe të gjitha vështirësitë që ju përmendët, si transporti e të tjera.

Pyetja tjetër ka lidhje me kostot. Është e vërtetë që në Shqipëri mbulojmë kostot e librave në shkollat fillore, ndërsa nivelet e tjera janë me pagesë. Cila do të jetë politika dhe raporti për fëmijët që jetojnë brenda kufijve dhe atyre që jetojnë jashtë, pra a do të ndjekim të njëjtën politikë që shteti të subvencionojë deri në atë moshë sa subvencionon edhe brenda kufijve, apo do ta zgjerojë më tepër?

Unë besoj shumë, përtej faktit që mbetem klasike në perceptim dhe nuk e imagjinoj dot që një libër që quhet abetare të mund të shfletohet në një ekran kompjuteri apo IPD-i. Duhet ta kesh fizikisht. Megjithatë, ajo që dua të më përcaktoni ju është fakti nëse botimet e para të Abetares apo të gjitha librave, me të cilat mësojnë shqip fëmijët që jetojnë në diasporë, do të jenë për vitin e ardhshëm shkollor, pra nga shtatori e tutje, sepse ky vit shkollor ka filluar, ndërkohë buxheti hapet në janar. Madje, në janar është *de jure*, se *de facto* hapet në fund të shkurtit. Nëse zoti Fino me ndihmon me *deadline*-et faktike të hapjes fizikisht të buxhetit. Pra, presupozohet se, duke kërkuar të gjitha afatet kohore, vetë procesi i printimit, i tenderimit të librave, duhet të fillojnë të paktën në qershor dhe korrik që shpërndarja të bëhet në shtator. Pra, flasim si sot një vit më pas. Mbase ju bëra shumë pyetje, por... Faleminderit!

Pandeli Majko – Nuk ka problem.

Unë jua shpjegova që qendra e botimeve do të fillojë funksionimin më 1 janar dhe e gjithë shpërndarja e librave do të funksionojë, ashtu siç ka funksionuar çdo vit, pra Ministria e Arsimit dhe Ministria e Jashtme në bashkëpunim me njëra-tjetrën shpërndajnë të gjitha librat në bazë të kërkesave që vijnë nga ambasadat. Ky është mekanizmi që ka ekzistuar deri më sot që flasim. Çfarë ka ndodhur gjatë vitit buxhetor që ka kaluar?! Është krijuar grupi i punës dhe është bërë marrëveshja me qeverinë e Kosovës dhe aktualisht është përcaktuar kurrikula e përbashkët midis Shqipërisë dhe Kosovës për fëmijët e diasporës. Kjo do të thotë se do të ketë një program të veçantë për fëmijët shqiptarë në diasporë pa asnjë dallim. Nuk ka rëndësi nëse janë shqiptarë të Shqipërisë, të Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi e kështu me radhë. Studiuesit tani janë ulur dhe po bëjnë librat. Mbi këto libra që do të bëhen, ose që janë duke u bërë, vitin që vjen kjo qendër do të aplikojë punën e vet. Ka një arsye specifike, sepse do të marrë një certifikatë të veçantë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kanë një gjë të veçantë. Skënderbeu 1 është, por ne sot që flasim, kemi libra të ndryshëm në shqip, përveç Abetares, në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi. Fakti që ne do ta trajtojmë diasporën si një, na kërkonte një marrëveshje bashkëpunimi për të krijuar një kurrikul të përbashkët me Kosovën. Kjo marrëveshje është bërë dhe tani janë duke punuar grupet e përbashkëta. Fëmijëve që do të mbarojnë këtë kurs do t'u jepet një certifikatë e firmosur nga ministri i Arsimit të Kosovës dhe ministri i Arsimit të Shqipërisë. Pra, e kemi filluar ndryshimin e sistemit nga baza. Sigurisht që pritshmëritë janë të bëhet sa më shpjet dhe ne po punojmë ta bëjmë sa më shpejt. Kini parasysh, të nderuar kolegë, se si e filluam vitin e kaluar. Isha vetëm unë dhe zero ligje, akte, institucione dhe buxhete. Bëmë gati gjysmë shkelje, duke vënë një buxhet eterik për një agjenci që nuk ekzistonte, e cila kaloi më pas me ligjin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Sot kemi funksionale Agjencinë Kombëtare të Diasporës dhe Fondin e Zhvillimit.

Tani do të qëndroj pak te Fondi i Zhvillimit, sepse zoti Fino me të të drejtë pyeti se sa po punohet me projektet. Fondi i Zhvillimit qëllimin kryesor e ka të punojë me projektet, sidomos me projektet e huaja. Projektin e parë, sa për të filluar punën, e kanë marrë nga qeveria, kurse në vazhdim, pavarësisht se është institucion publik, duhet të punojë me projektet e huaja. Duhet të kemi parasysh që ne kemi një komunitet donatorësh, të cilët deri tani kanë investuar zero, hiq projektin e IOM-it në bashkëpunim me qeverinë italianë, i cili sapo ka filluar dhe me ritme të shpejta po jep rezultatet e para. Gjithsesi, duhet të punojmë edhe me donatorë të tjerë, të cilët deri tani për arsye të ndryshme, si dhe për shkak të mospasjes së asnjë strukture që të shkonte të trokiste

dhe të interesohej për këtë çështje, nuk kanë qenë të interesuar për të donuar apo për të hapur projekte për këtë çështje. Sot shteti shqiptar i ka strukturat për të ndjekur situatën, për të cilën sapo fola.

Mimi Kodheli – Faleminderit, Ministër!

A ka pyetje, apo komente?

Zonja Gjermani, a keni diçka për të shtuar?

Eglantina Gjermani – Në fakt, qoftë për tekstet, qoftë edhe për samitin e diasporës mendova që një pjesë e fondeve, mbase të parashikuara nga Ministria e Financave, mund të jenë pranë Ministrisë së Arsimit ose institucioneve të tjera që merren me organizmin e eventeve, si Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Qeveritare, sepse mendoj se duhet të jenë të parashikuara, të paktën me një buxhet modest.

Pandeli Majko – Jemi duke negociuar, zonja Eglantina. Për momentin do t'i lihen Këshillit të Ministrave, zyrës së Kryeministrit. Gjithë historia e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Qeveritare është se, po kaluan një pjesë e fondeve nga zëri i Këshillit të Ministrave, i Kryeministrit, te DSHQ-ja, u shtuaka një vlerë 20%, sepse ai është institucion fitimprurës dhe duhet të mbajë një 20% në bazë të ligjit dhe heq një vleftë efektive të trajtimit të fondeve. Vetëm për efekt të kësaj ne mendojmë që mund të kalojë direkt te DSHQ-ja jo për ndonjë efekt të natyrës tjetër.

Eglantina Gjermani – Ndërkohë, edhe unë mbështes idenë e thithjes së fondeve jo vetëm me projekte nga organizata ndërkombëtare, por edhe nga vetë diaspora, sepse, duke kontribuar ,bëhet më përfshirëse dhe janë më të interesuar dhe më të angazhuar për të bashkëpunuar, sepse gjithmonë buxheti i shtetit do të jetë modest brenda këtyre mundësive financiare që ka shteti shqiptar.

Pandeli Majko – Ne jemi të kujdesshëm në këtë pikë. Jemi duke punuar me qeverinë e Kosovës për hapjen e dhomës së biznesit të diasporës, bazuar mbi të njëjtin *network* biznesmenësh të diasporës, dhe mbase do ta asistojmë, në qoftë se na kërkojnë ndihmë, për një bankë të diasporës, por të gjitha këto janë ende të shkruara në letër. Duke pasur parasysh mënyrën sesi e nisëm dhe se ku jemi sot, tentojmë të them se jemi në rrugën e duhur.

Mimi Kodheli- Ministri Majko, ju falënderoj!

Sot diskutimi është në parim dhe javën tjetër do të kemi mundësi të diskutojmë në detaje. Meqenëse e keni kërkuar në qeveri, e kërkon edhe këtu një rritje të fondeve që ju janë alokuar nga

projektbuxheti, me arsyen që ju paraqitët dhe me të drejtë pretendoni se duhet të jenë, bashkëpunëtorët tuaj janë të lutur të vijnë për të ridefinuar ndoshta një rialokim të mundshëm të fondeve. Kështu që, nëse nuk ka pyetje dhe diskutime të tjera, unë i ftoj kolegët ta kalojmë projektligjin në parim, pastaj, me gjithçka që u tha këtu dhe me pretendimet tuaja, të gjitha këto do t'i përcillen komisionit përgjegjës, që është Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, i cili do të dalë me një raport final para se projektbuxheti i vitit 2019 të kalojë për miratim në parlament.

Ju falënderoj për prezencën!

Kush është dakord me projektligjin? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Ministri Majko, faleminderit për pjesëmarrjen!